



SIGURIMI I DETYRUESHËM MOTORIK NË SHQIPËRI. SFIDAT E LIBERALIZIMIT

Sigurimi motorik është një nga llojet më të rëndësishme të sigurimit që ofrohet në vendet në zhvillim dhe mund të jetë nga klasat e para të sigurimit, për të cilat publiku i gjerë disponon një perceptim të përgjithshëm. Arsyeja kryesore që sigurimi motorik në shumë vende është i detyrueshëm lidhet me mbrojtjen e publikut.

Vijon në faqen 2

VËSHTRIM MBI TREGJET

Tregu i sigurimeve për vitin 2011

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për vitin 2011 arritën shifrën 8,356,115 mijë lekë, me një rritje mbi 1.8% më shumë se viti i kaluar.

Vijon në faqen 5

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë për vitin 2011

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë vitit 2011 u dominua në masën më të madhe nga transaksionet në instrumenta afatshkurtër (bono thesari).

Vijon në faqen 7

Tregu i pensioneve private vullnetare për vitin 2011

Zhvillim i rëndësishëm gjatë vitit 2011 në tregun e pensioneve private vullnetare ka qenë licencimi i operatorëve, që pritet të luajnë një rol të rëndësishëm në maturimin e këtij tregu, duke rritur më tej besueshmërinë e publikut në investimin e fondeve në skemën e pensioneve private vullnetare.

Vijon në faqen 8

EDUKIMI I KONSUMATORIT

Autoritetet mbikëqyrëse të pensioneve private dhe roli i tyre në edukimin financiar. (Material i përpunuar, nxjerrë nga faqja zyrtare e OECD-së, nëntor 2011)

Vijon në faqen 9

ZHVILLIME TË TJERA

Komiteti Kombëtar Drejtues për reformën zhvillon takimin mbi projektin për përmirësimin e raportimin financiar të shoqërive.

Vijon në faqen 10

Instituti për Stabilitetin Financiar (Zvicër) zhvilloi takimin: Risigurimi dhe metoda të tjera të transferimit të riskut.

Vijon në faqen 10

Autoriteti i Shërbimeve Financiare, Maltë në bashkëpunim me Komisionin e Letrave me Vlerë dhe Bursën e SHBA-së zhvilluan trajnimin mbi investigimin dhe mbikëqyrjen e tregut të letrave me vlerë.

Vijon në faqen 12

TË REJA NGA RAJONI

Sloveni: Zhvillime në tregun e sigurimeve. Ecuria e MTPL-së.

Vijon në faqen 13

Kosovë: Tregu në 3 mujorin e tretë të vitit 2011 mbyllet me një rritje prej 7%.

Vijon në faqen 13

SIGURIMI I DETYRUESHËM MOTORIK NË SHQIPËRI. SFIDAT E LIBERALIZIMIT

Rëndësia dhe zhvillimet e sigurimit motorik

Sigurimi motorik është një nga llojet më të rëndësishme të sigurimit që ofrohet në vendet në zhvillim dhe mund të jetë nga klasat e para të sigurimit, për të cilat publiku i gjerë disponon një perceptim të përgjithshëm. Arsyeja kryesore që sigurimi motorik në shumë vende është i detyrueshëm lidhet me mbrojtjen e publikut.

Sigurimi i detyrueshëm motorik është prezantuar në ish ekonomitë e planifikuara vetëm në dekadën e fundit dhe kuptohet shumë pak. Drejtuesit e automjeteve ndodh shpesh të kenë perceptim për sigurimin e detyrueshëm motorik më tepër si një formë takse, të cilën ata mund ta shmangin, sesa si mbrojtje kundrejt përgjegjësive që ata kanë ndaj të tretëve, koncept ky, me të cilin publiku i gjerë ende nuk është familjarizuar.

Në vendin tonë, sigurimi i detyrueshëm motorik, hyri në fuqi për herë të parë në 1.1.1993, në bazë të dekretit të Presidentit të Republikës me nr. 295, datë 15.09.1992. Në bazë të këtij dekreti, mbajtësi i një mjeti motorik detyrohej të lidhte me një sigurues të autorizuar, një kontratë për sigurimin e përgjegjësive së tij ndaj personave të tretë për dëmet që mund të shkaktonte nga përdorimi i mjetit motorik.

Rritja e vazhdueshme e numrit të automjeteve të hyra në vendin tonë, ka sjellë si pasojë zhvillimin me shpejtësi të tregut të sigurimeve

të detyrueshme motorike. Referuar statistikave të tregut të sigurimeve, sigurimi i mjeteve motorike zë peshën kryesore në treg. Ky zhvillim ka bërë që disa herë të ketë ndryshime ligjore në përgjigje të tendencave të tregut, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit dhe përafrimit me standardet ndërkombëtare.

Ndryshimet e tregut motorik në legjislacion

Ndryshimi më i fundit i legjislacionit për sigurimin e detyrueshëm motorik është Ligji nr. 10455, datë 21.07.2011”Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Këto ndryshime sollën dhe liberalizimin e tarifave të sigurimit të detyrueshëm, duke i dhënë të drejtën shoqërive të sigurimit të përcaktojnë vetë tarifat e primit të sigurimit, sipas kushteve të tregut, dhe të fillojnë t’i zbatojnë ato, pasi njoftohet zyrtarisht Autoriteti. Pavarësisht tarifave të liberalizuara të primit të sigurimit të detyrueshëm, shoqëritë e sigurimit krijojnë rezervat teknike dhe provigjonet, jo më pak se niveli i rezervave teknike dhe provigjoneve, të përcaktuara nga Autoriteti. Kjo është një masë për të garantuar që shoqëritë të jenë në gjendje të vlerësojnë drejtë detyrimet që kanë ndaj publikut edhe në rastet kur shoqëritë nuk ndjekin politikë të kujdesshme tarifimi.

Eksperiencat evropiane për procesin e liberalizimit të tregut të sigurimit të detyrueshëm motorik

Sigurimi i Detyrueshëm Motorik në Bashkimin Evropian i është nënshtruar

Në kushtet e një tregu të lirë e rëndësishme është të monitorohet shëndeti financiar i operatorëve për angazhimet që ata kanë ndaj publikut dhe përgjegjësitë për të shlyer dëmet sipas kontratave të lidhura me publikun.

procesit të liberalizimit relativisht vonë, përgjatë periudhës 1968-1994 dhe shërben si shembull i mirë në drejtim të hapave të nevojshëm dhe kushteve që duhen plotësuar për të prezantuar një treg të lirë në drejtim të tarifave. Parimi i lirisë për vendosjen e tarifave për vendet e Bashkimit Evropian buron nga direktiva që lidhet me “lirinë e ofrimit të shërbimeve dhe të drejtës së vendosjes” e vitit 1988, e ndryshuar në vitin 1990 dhe 1992. Në praktikë, vende të ndryshme evropiane e kanë përfunduar këtë proces në kohë dhe mënyra të ndryshme. Franca ka qenë ndër vendet që ka patur një kontroll minimal të tarifave, që pas Luftës së Dytë Botërore dhe ka përfunduar procesin e liberalizimit në vitin 1986. Në Spanjë liria për të vendosur tarifën nga sektori i sigurimeve u bë e mundur në vitin 1984. Britania e Madhe nuk ka patur kontroll të tarifave për dekada të tëra, ndërsa Gjermania e përfundoi procesin e lirisë së tarifimit në vitin 1994.

Italia ka qenë dhe vendi i fundit i Evropës Perëndimore që iu nënshtrua procesit të lirisë së tarifave në zbatim të

direktivës evropiane, në vitin 1994. Më parë, tarifën administroheshin nga një komitet ministror dhe struktura e tarifave ishte e njëjtë për të gjithë tregun. I vetmi ndryshim për blerësit e sigurimit ishte zbatimi i tre faktorëve që ndikonin në normën e sigurimit: fuqia motorike, zona e banimit dhe zbatimi i një shkalle Bonus-Malus. Niveli i ngarkesave (për shpenzimet e përgjithshme) që zbatoheshin mbi primin e riskut nga shoqëritë e sigurimit ishte përsëri i kufizuar dhe varej nga tendencat historike të regjistruara nga secila shoqëri.

Kërkesat e direktivave evropiane për lirinë e vendosjes së tarifave sipas tregut të lirë dhe avantazhet që kjo i sjell tregut shqiptar të sigurimeve në këndvështrimin afat-gjatë, kanë bërë që Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të ketë një strategji të qartë veprimi për kalimin drejt një tregu eficient të sigurimit të detyrueshëm motorik.

Kërkesat e direktivave evropiane për lirinë e vendosjes së tarifave sipas tregut të lirë, kanë bërë që AMF të ketë një strategji të qartë veprimi për kalimin drejt një tregu eficient të sigurimit të detyrueshëm.

Tabelë: Të dhëna mbi sigurimin e detyrueshëm motorik nga disa vende evropiane

Vendi	Pesha e sigurimit të detyrueshëm motorik në primet e jo-jetës (në %)	A kërkohet miratimi i tarifave?	A duhen depozituar tarifën në Autoritet
Kosovë	72	Po	Po
Kroaci	58	Po	Jo
Mali i Zi	54	Po	Po
Shqipëri*	52	Jo	Po
Maqedoni	50	Po	Po
Serbi	40	Po	Po
Lituani	36	Jo	Jo
Bullgari	34	Jo	Po
Poloni	34	Jo	Po
Sloveni	30	Jo	n.a
Slovaki	30	Jo	Jo
Hungari	28	Jo	Jo
Estoni	28	Po	Jo
Rumani	27	Jo	Po
Austri	19	Jo	Jo

(Renditja është bërë sipas peshës specifike që zë sigurimi i detyrueshëm motorik në primet e jo-jetës)
Burimi - Takimi rajonal i CESEE, prill 2011, Vjenë, Austri.

Burimi * - Raport Statistikor viti 2011 (AMF) www.amf.gov.al

Në kushtet e një tregu të lirë e rëndësishme është të monitorohet shëndeti financiar i operatorëve për angazhimet që ata kanë ndaj publikut dhe përgjegjësitë për të shlyer dëmet sipas kontratave të lidhura me publikun. Theksi në tregjet e lira vendoset tek tarifimi i kujdesëshëm dhe i drejtë i produktit dhe jo tek miratimi i çmimeve. Në tabelën e mësipërme jepen disa krahasime me vende të Evropës, Qendrore, Lindore e Juglindore, në lidhje me peshën që zë sigurimi i detyrueshëm motorik dhe procesi i miratimit ose jo i tarifave.

Sfidat shqiptare për liberalizimin të tregut të sigurimit të detyrueshëm

Me asistencën e Bankës Botërore dhe financim të “First Initiative”, në shtator të vitit 2011, filloi zyrtarisht projekti që do të asistojë AMF në orientimin e drejtë të procesit të liberalizimit. Fillimisht është vëzhguar situata aktuale në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik, si dhe janë përcaktuar hapat e mëtejshëm në përmbushje të objektivave kryesore të projektit: zhvillimi i politikave dhe proceseve drejt tarifimit me bazë riskun të produkteve të sigurimit të detyrueshëm motorik, si dhe përafrimi i kuadrit aktual ligjor që rregullon sigurimin e detyrueshëm motorik me direktivat e BE-së.

Ky projekt vjen në një moment tepër të rëndësishëm për tregun shqiptar të sigurimeve, menjëherë pas heqjes me ligj të regjimit të tarifave fikse në sigurimin e detyrueshëm motorik. Në këto kushte, projekti do të synojë të adresojë disa çështje të rëndësishme

për të lehtësuar tranzicionin drejt një tarifimi më eficient, që është ai me bazë riskun. Një nga aspektet më të rëndësishme është që AMF të ketë mjetet e duhura për t’u siguruar që shoqëritë e sigurimit mbajnë provigjone të mjaftueshme për përgjegjësitë që ato kanë ndërmarrë, duke e konceptuar në dy forma:

- Ndërtimi i një procesi për të verifikuar nëse provigjonet për dëme janë të mjaftueshme për situatat e njohura, si dhe;

- Ndërtimi i një procesi për të siguruar që biznesi dhe risqet e rinovueshëm sigurohen me çmime teknikisht të pranueshme.

Projekti do të ketë në vëmendje dhe disa përmirësime që mund t’i bëhen Qendrës së Informacionit të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik, me fokus dhe ngritjen e fazës së tretë të saj, sistemin Bonus-Malus. Po kështu do të bëhet i mundur dhe zhvillimi i një strategjie për menaxhimin e numrit të të pasiguarve.

Pritshmëritë e projektit janë tepër konkrete duke i dhënë formë dhe strategjisë që AMF ka patur për liberalizimin e sigurimit të detyrueshëm motorik. Pavarësisht sfidave aktuale me të cilat përballet tregu i sigurimeve në fazat e para të zbatimit të tarifave sipas tregut të lirë, AMF, në bashkëpunim me tregun, do të synojë një tranzicion sa më të lehtë drejt ofrimit të një produkti cilësor të sigurimit të detyrueshëm motorik, në funksion të ndërtimit të një tregu të qëndrueshëm e eficient.

VËSHTRIM MBI TREGJET


Tregu i sigurimeve për vitin 2011

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për vitin 2011 arritën shifrën 8,356,115 mijë lekë, përkundrajt 8,207,485 mijë lekë të realizuara në vitin 2010 ose 1.81% më shumë se viti i kaluar. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 55.30% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 44.70% të tregut. Përsa i takon rritjes së tregjeve, në veçanti, kemi një rritje në masën

25.53% të sigurimeve të Jetës dhe një rënie prej 0.43% të sigurimeve të Jo-Jetës. 87.03% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës, 12.75% nga veprimtaria e Jetës dhe 0.22% u gjenerua nga veprimtaria e risigurimit.

Në vitin 2011 u nënshkruan 1,306,610 kontrata sigurimi, ose 77.46% më shumë se në vitin 2010.

Struktura e tregut të sigurimeve, për vitin 2011




Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 55.30% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 44.70% të tregut.

Volumi i primit të shkruar bruto, për vitin (2010-2011)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë Lekë)	
	2010	2011
A) Sigurim i Jetës	848,804	1,065,511
B) Sigurim i Jo-Jetës	7,303,484	7,272,241
<i>Nga këto:</i>		
a) Sigurimi Detyrueshëm	4,242,526	3,734,793
b) Sigurimi Vullnetar (Jo-Jetë)	3,060,958	3,537,448
C) Risigurimi	55,197	18,403
TOTAL	8,207,485	8,356,155

Volumi i primit të shkruar bruto, për vitin 2011 (Jeta dhe Jo-Jeta)



Sigurimet e detyrueshme motorike

Në vitin 2011, sigurimet e detyrueshme motorike sollën 3,734,793 mijë lekë të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme për vitin 2011, arritën 2,212,854 mijë lekë, ose 24.55% më pak se në vitin 2010.

Në vitin 2011, primet e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin 1,102,217 mijë lekë, ose rreth 22.98% më shumë se në vitin 2010. Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë vitit 2011 arritën në 419,722 mijë lekë, apo 1.56% më shumë se në vitin 2010.

Sigurimet vullnetare

Për vitin 2011, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 4,621,362 mijë lekë, ose 16.56% më shumë se të ardhurat një viti më parë. Rritja e primeve në sigurimet vullnetare vazhdon të lidhet ngushtë me nivelin e kreditimit nga bankat dhe hyrjen e investitorëve të mëdhenj, kryesisht në infrastrukturë.

Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, me të ardhura 3,537,448 mijë lekë, vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe rreziqet natyrore me 34.44% të pasuara nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit me 24.94%, dhe nga sigurimi kasko me 17.70%, peshë më të ulët patën sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile, sigurimet e garancisë.


Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit, në vitin 2011, arritën në 874,419 mijë lekë, 91.09% më shumë se në vitin 2010. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e shëndetit në udhëtim me 88.51% të të ardhurave të këtij grupi. Primet në sigurimet e Jetës në vitin 2011 arritën në 1,065,511 mijë lekë, ose 25.53% më shumë se në vitin 2010. Rritja në sigurimet e Jetës është e lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredidhënies.

Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit


Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet ndërmjet shoqërive të sigurimit: Sigal Uniqa Group Austria, Sigma Vienna Insurance Group, Insig,

Atlantik, Interalbanian, Albsig, Intersig dhe Eurosig. Sigal Uniqa Group Austria udhëhoqi tregun me 32.76 % të primeve.

Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, për vitin 2011 (Jo-Jeta)



Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, për vitin 2011 (Jeta)



Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë Sigal-Life Uniqa Group Austria, Insig dhe Sicred. Sigal-Life Uniqa Group Austria udhëhoqi tregun me 47.95 % të primeve.

Dëmet


Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në vitin 2011 kapi vlerën 2,193,472 mijë lekë, ose 4.30% më pak se në vitin 2010. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimit motorik me 1,713,527 mijë lekë, apo 78.12% të totalit.

Rritja e primeve në sigurimet vullnetare vazhdon të lidhet ngushtë me nivelin e kreditimit nga bankat dhe hyrjen e investitorëve të mëdhenj, kryesisht në infrastrukturë.

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë për vitin 2011

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë vitit 2011 u dominua në masën 94.41% nga transaksionet në instrumenta afatshkurtër (*bono thesari*) dhe 5.59% nga instrumenta afatgjatë (*obligacione*). Përsa i takon numrit të transaksioneve, 98.72% e të gjithë transaksioneve të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Letra me Vlerë të Qeverisë, 2011



- A - Blerje në tregun primar
- B - Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar
- C - Blerje nga individët para afatit të maturimit
- D - Vendosi e bonos si kolateral
- E - Shlyerje e vlerës nominale në maturim

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për vitin 2011, flasin për një dominim të transaksioneve

“Shlyerje e vlerës nominale në maturim” dhe “Blerje në tregun primar” përkatësisht me 41.56% dhe 27.30% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë vitit 2011 ka patur një rënie prej 4,707.83 milionë lekë ose në masën 40.44%, krahasuar me vitin 2010, shoqëruar me një rënie në masën 19.93% të numrit të transaksioneve.

Transaksioni i llojit C “Blerje nga individët para afatit të maturimit” gjatë vitit 2011 ka patur një rënie prej 1,084.84 milionë lekë ose 25.88%, krahasuar me vitin 2010, ndërkohë ka patur një rritje në masën 12.08% të numrit të transaksioneve.

Krahasuar me vitin 2010, vihet re një rënie në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C, të marra së bashku, me rreth 5,792.67 milionë lekë.

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë vitit 2011 u dominua në masën 94.41% nga transaksionet në instrumenta afatshkurtër (*bono thesari*) dhe 5.59% nga instrumenta afatgjatë (*obligacione*).

Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë për vitin 2010, 2011

Lloji i Transaksionit	Vlera nominale (në mln lekë)		Ndryshimi (në %)
	2010	2011	'11/10-1
Letra me Vlerë të Qeverisë			
B Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar	11,642.63	6,934.80	(40.44)
<i>Individë</i>	7,278.34	5,781.30	(20.57)
<i>Persona juridikë</i>	4,364.29	1,153.49	(73.57)
C Blerje nga individët para afatit të maturimit	4,192.42	3,107.58	(25.88)
<i>Individë</i>	2,747.46	1,686.75	(38.61)
<i>Persona juridikë</i>	1,444.95	1,420.83	(1.67)

Tregu i pensioneve private vullnetare për vitin 2011

Nëpërmjet këtij informacioni synohet të jepet një panoramë mbi zhvillimet kryesore në tregun e pensioneve private vullnetare gjatë vitit 2011.

Zhvillim i rëndësishëm gjatë vitit 2011 në tregun e pensioneve private vullnetare ka qenë licencimi i operatorëve, që pritet të luajnë një rol të rëndësishëm në maturimin e këtij tregu, duke rritur më tej besueshmërinë e publikut në investimin e fondeve në skemën e pensioneve private vullnetare. Një aspekt i rëndësishëm në punën e AMF-së pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, ka qenë plotësimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor. Skema e re e organizimit dhe funksionimit të pensioneve private vullnetare, e sanksionuar në ligjin e ri, përbën një risi për tregun financiar shqiptar. Në janar të vitit 2011 në treg

zhvillonte aktivitetin një operator i licencuar sipas kërkesave të reja, ndërsa gjatë vitit u licencuan dhe 2 operatorë të tjerë.

Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare në fund të vitit 2011, tregon një total të ardhurash nga kontributet prej 177 mln lekë prej të cilëve rreth 44% paguhet nga anëtarët, ndërsa pjesa tjetër nga punëdhënësit. Vlera mesatare e kontributit mujor të derdhur në fondet e pensioneve private vullnetare gjatë këtij viti ka variuar nga 2,000 lekë deri në 13,600 lekë në varësi të fondit. Gjatë vitit 2011, numri i anëtarëve aktivë, ose anëtarëve, që kanë kryer të paktën një derdhje kontributi, është 5,275 nga 6,295 anëtarë gjithsej që janë të regjistruar deri më 31 dhjetor 2011 në këto fonde.


Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare në fund të vitit 2011, tregon një total të ardhurash nga kontributet prej 177 mln lekë prej të cilëve rreth 44% paguhet nga anëtarët, ndërsa pjesa tjetër nga punëdhënësit.

Tabela: Indikatorë të fondeve të pensioneve (30.09.2011)


Indikatorë të fondeve të pensioneve	30.09.2011
Totali i asetëve (në lekë) mln	142*
Të ardhura neto nga investimet (në lekë) mln	6
Kthimi mesatar nominal neto nga investimet	5%

* përfshin asetet e dy shoqërive administruese të fondeve që janë licencuar deri më 30.09.2011

Struktura e aktiveve të tregut të fondeve private vullnetare të pensioneve (30.09.2011)



Ecuria e numrit të anëtarëve në fondet private të pensione në vite



EDUKIMI I KONSUMATORIT

Përmirësimi i edukimit financiar dhe ndërgjegjësimi për sigurimet dhe pensionet private

(Material i përpunuar, nxjerrë nga faqja zyrtare e OECD-së, nëntor 2011)

OECD pranon se edukimi financiar është veçanërisht i rëndësishëm në lidhje me pensionet, për shkak të faktit se këto të fundit janë kontrata afatgjata me mbulim të gjerë shoqëror, duke qenë njëkohësisht edhe produkte veçanërisht të ndërlikuara. Po të shtosh këtu edhe faktin se, megjithëse individët po marrin gjithnjë e më shumë risqe të lidhura me financimin, pensionet e tyre të pleqërisë janë ndër produktet financiare më pak të kuptuara, atëherë nevoja për fushata të edukimit financiar në lidhje me pensionet bëhet e qartë.

Në këtë material shpjegohen disa nga pikat kryesore të paraqitura në botimin e OECD-së “IOPS (2011), Autoritetet mbikëqyrëse të pensioneve dhe

edukimi financiar: mësimet e nxjerra”, që është material informativ i IOPS-it. Informacioni që përmban ky material është përpiluar nga një pyetësor i gjerë për çështjet e komunikimit dhe edukimit financiar, i cili u është shpërndarë anëtarëve në fillim të vitit 2011.

Ky studim i përgatitur nga OECD pranon edhe që shumë palë interesi mund të luajnë një rol në ofrimin e një edukimi financiar të tillë, ndërkohë që IOPS ka theksuar më parë se autoritetet mbikëqyrëse të pensioneve mund të luajnë një rol të rëndësishëm në fushatat e lidhura me pensionet.

Materialin e plotë e lexoni duke filluar nga numri i ardhshëm

ZHVILLIME TË TJERA

Komiteti Kombëtar Drejtues për Reformën zhvillon takimin mbi projektin për përmirësimin e raportimit financiar të shoqërive

Më 24 janar 2011, Komiteti Kombëtar Drejtues për Reformën zhvilloi në ambientet e Ministrisë së Financave, takimin e radhës mbi projektin e përmirësimit të raportimit financiar të shoqërive (PPRS).

Qëllimi i projektit ishte krijimi i një ambienti transparent politikash dhe kornizash efektive institucionale për raportimin financiar të shoqërive, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Projekti për përmirësimin e raportimit financiar të shoqërive zbatohet nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Financave me mbështetjen e programit REPARIS të Bankës Botërore.

Projekti është financuar nga fondet "trust-fund" të administruara nga Banka Botërore, me kontribut të Sekretariatit Zviceran të Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO).

Në takim u diskutuan arritjet e deritanishme të fazës aktuale të projektit, si dhe komponentët përbërës të tij, të cilët janë:

1. Përmirësimi i kuadrit ligjor në fushën e raportimit financiar të shoqërive;

2. Fuqizimi i kapaciteteve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit;
3. Forcimi i sistemit të mbikëqyrjes së auditivit, si dhe;
4. Përmirësimi i programeve mësimore të kontabilitetit dhe auditimit për arsimimin universitar dhe certifikimin profesional.

Projekti krijon përfitime indirekte për AMF-në, kryesisht të përqendruara në dy drejtime:

- Së pari, projekti synon të arrijë përmirësime në cilësinë e profesionistëve (kontabilistëve dhe ekspertëve kontabël të regjistruar, përmes trajnimeve dhe mbështetjes për organizatat profesionale), gjë që mund të ndikojë në raportimet financiare të shoqërive të sigurimit.
- Së dyti, projekti ka si qëllim mbështetjen dhe fuqizimin e Bordit të Mbikëqyrjes Publike (me të cilën Autoriteti ka edhe marrëveshje bashkëpunimi (MoU)), gjë që do të çojë në një punë më efektive të këtij bordi dhe në rritjen e cilësisë së auditimeve të kryera nga ekspertët kontabël të regjistruar.

Bazel: Instituti për Stabilitetin Financiar diskuton mbi Solvency e çështjet aktuariale dhe mbi risigurimin

Instituti për Stabilitetin Financiar në bashkëpunim me IAIS, zhvilloi gjatë periudhës 30 janar deri më 1 shkurt, në Bazel, takimin midis grupeve të punës, në të cilët AMF ishte e pranishme me statusin e vëzhguesit.

Grupet e punës të nënkomitetit përgjegjës mbi Solvency dhe çështjet aktuariale, si dhe nënkomitetit përgjegjës për risigurimin përbëhen nga përfaqësues të lartë të autoriteteve mbikëqyrëse të SHBA-së, Japonisë,

Projekti për përmirësimin e raportimit financiar të shoqërive zbatohet nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Financave me mbështetjen e programit REPARIS të Bankës Botërore.

Evropës, Shoqatës Ndërkombëtare të Aktuarëve (IAA), etj.

Kuadri i përbashkët nën të cilin këto grupe pune zhvillojnë aktivitetin është ai i Solvency II, një projekt rregullator i cili siguron një qasje me bazë riskun, me bazë ekonomike dhe me bazë principesh për mbikëqyrjen e risiguruesve në Evropë e më gjerë.

Një nga çështjet e cila u diskutua gjatë punimeve të grupit të punës, përgjegjës për Solvency dhe çështjet aktuariale të lidhura më të, u përqendrua në diskutimin e qasjeve të ndryshme të cilat mund të aplikohen mbi zhvillimin e komponentëve përbërës së kapitalit, me qëllim realizimin e testimit të solvabilitetit. Modeli Zviceran i testimit të solvabilitetit, Swiss Solvency Test (SST), i cili iu prezantua si shembull grupit të punës, ka për qëllim kryesor të mbështetet në një mbikëqyrje me bazë principet. Kështu, ky model testimi i solvabilitetit, si një element kyç i mbikëqyrjes me bazë riskun, është një shembull i kësaj qasje dhe nënkupton që autoriteti mbikëqyrës nuk ndalet thjesht tek zbatueshmëria e rregullave në fuqi por përcakton edhe udhëzime lidhur me limitimin e riskut, zbatueshmëria e të cilave është jo vetëm përgjegjësia por dhe interesi i vetë siguruesve.

Një pjesë shumë e rëndësishme e diskutimit u përqendrua në komponentët e kapitalit me qëllim vlerësimin e solvabilitetit në kuadër të Com Frame (kuadër rregullator), i cili ka si qëllim të asistojë autoritetet mbikëqyrëse në adresimin e risqeve që lindin prej grupeve ndërkombëtarë aktivë në sigurime, risqe të cilët mund të kenë origjinë të ndryshme. Autoritetet mbikëqyrës do të kenë mundësi që nëpërmjet këtij kuadri rregullator të vendosin në zbatim një

qasje të përbashkët lidhur me çështje mbi mbikëqyrjen dhe që janë të rëndësishme.

Ulja e varësisë nga agjencitë e klasifikimit (rating agencies), prej rregullatorëve dhe siguruesve, së bashku me nevojat për trajnim lidhur me këtë kuadër të ri rregullator ishin gjithashtu në fokusin e këtij grupi pune.

Puna e nënkomitetit përgjegjës për risigurimin u përqendrua në diskutime të ndryshme lidhur me risigurimin dhe forma të tjera të transferimit të riskut në kuadrin e Com Frame, siç është përzgjedhja potenciale e risiguruesve në këtë kuadër, perspektivat e industrisë, si dhe risku sistemik që mund të derivojë prej tyre.

Lidhur me riskun sistemik, parë nga perspektiva e risiguruesve, përfaqësues të Swiss Re dhe Munich Re, trajtuan çështje lidhur me: përqendrimin në tregun e risigurimeve, përqendrim i cili rezultoi i ulët sipas indeksit Herfindahl të përdorur për këtë qëllim; ndërlidhjen e tregjeve të risigurimit dhe sigurimit në rastet e falimentimeve historike të pjesëmarrësve të këtij tregu; rritjen e çmimit të risigurimit si përgjigje ndaj katastrofave natyrore, etj. Nga skenarët e studiuar dhe stres testet e përdorura në studimin e tyre, risiguruesit konkluduan që risku sistemik që mund të derivojë nga risiguruesit është jo material, kjo bazuar dhe në faktin që vetëm rreth 5% e primeve globale të sigurimit cedohet në risigurim.

Për AMF-në, pjesëmarrja në këto grupe pune, është e një interesi të veçantë në aspektin e informacioneve të marra nga eksperiencia në tregjet botërore dhe efektet që ky kuadër i ri rregullator mund të ketë mbi tregun e sigurimeve në Shqipëri.

Modeli Zviceran i testimit të solvabilitetit, Swiss Solvency Test (SST), i cili iu prezantua si shembull grupit të punës, ka për qëllim kryesor të mbështetet në një mbikëqyrje me bazë principet.

Pjesëmarrja në këtë aktivitet i shërbeu shkëmbimit të informacionit drejt zhvillimit të tregut të letrave me vlerë, si dhe forcimit të bashkëpunimit me institucionet pjesëmarrëse, rajonale, pjesë e këtij programi.

Maltë: investigimi dhe mbikëqyrja e tregut të letrave me vlerë

Autoriteti i Shërbimeve Financiare, Maltë (MFSA) në bashkëpunim me Komisionin e Letrave me Vlerë dhe Bursën e SHBA-së (SEC) zhvilluan gjatë periudhës 23-26 janar, në Maltë, trajnimin mbi investigimin dhe mbikëqyrjen e tregut të letrave me vlerë. Në këtë aktivitet merrnin pjesë përfaqësues nga autoritetet që mbikëqyrin tregun e letrave me vlerë nga 15 vende të Evropës.

Diskutimi i metodave praktike dhe efektive për mbikëqyrjen dhe inspektimin e pjesëmarrësve të tregut, kryerjen e hetimeve dhe marrjen e veprimeve efektive në zbatim të tij, duke e vënë theksin tek broker-dealer, këshilltarët e investimeve, kompanitë e investimeve, fondet e investimeve, fondet e investimeve për mbulimin e risqeve, dhe fondet private të kapitalit ishte dhe synimi zhvillimit të këtij trajnimi drejt shkëmbimit të përvojave të rregullatorëve në sektorin e letrave me vlerë, në funksion të zbatimit të ligjit për mbikëqyrjen e tregut të letrave me vlerë.

Programi u fokusua në metodat praktike dhe efektive për mbikëqyrjen

dhe inspektimin e pjesëmarrësve të tregut, Lektorët e kualifikuar të Komisionit të Letrave me Vlerë dhe Bursës së SHBA-së (SEC) trajtuan një gamë të gjerë temash.

U trajtuan çështje në zbatim të programeve efektive mbi ekzaminimin dhe zbatueshmërinë, të procedurave të përputhshmërisë dhe rregullave të veprimtarisë për këshilltarët e investimeve dhe broker-dealer, për hetimet dhe ndjekjet penale, gjobat dhe sanksionet e tjera, për praktikatat e paligjshme të tregtimit, mashtrimet në raportimin financiar, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe çështje që kanë të bëjnë me manipulimin e tregut dhe tregtimin mbi bazën e informacionit të brendshëm, duke përfunduar me çështjet që lidhen me bashkëpunimin ndërkombëtar për mbikëqyrje efektive.

Pjesëmarrja në këtë aktivitet i shërbeu shkëmbimit të informacionit drejt zhvillimit të tregut të letrave me vlerë, si dhe forcimit të bashkëpunimit me institucionet pjesëmarrëse, rajonale, pjesë e këtij programi.

TË REJA NGA RAJONI

Sloveni: Zhvillimet e tregut të sigurimeve për 9-mujorin

Tregu i sigurimeve slovene tregoi një evolucion të qëndrueshëm në nëntë muajt e parë të vitit 2011, me një rritje të përgjithshme prej 1,15% premium, deri në 1.62 miliard euro të primit të shkruar bruto. Megjithatë, vlen të përmendet se dëmet e paguara regjistruan një ritëm shumë më të lartë rritje, prej gati 6%, për shkak të dëmshpërblimeve të paguara në sigurimin e Jetës. Sipas vlerësimeve të Shoqatës Slovene të Sigurimeve, deri në fund të vitit 2011, tregu sloven do të arrijë 2.16 bilion euro në primin e shkruar bruto, ose 2.8% më të lartë se në vitin 2010.

Tregu i sigurimeve të Jo-Jetës tregoi që është më i balancuari në 3 mujorin e tretë të vitit 2011, me një rritje 1,22% në primin e shkruar bruto dhe rënie 2% në dëmet e paguara. Performanca më e mirë në këtë drejtim i përket

klasës “Zjarri dhe rreziqet shtesë”, e cila përfitoi për shkak të kushteve ekstreme të motit gjatë këtij viti.

Sigurimi motorik, i cili llogarit pothuajse 38% të biznesit të Jo-Jetës, vazhdoi për të regjistruar një trend negativ, duke raportuar një vëllim 3% më të ulët në primin e shkruar bruto.

Në këtë aspekt, Sllovenia është ndoshta i vetmi treg i vendeve të CEE-së, ku sigurimi kasko hyri në një udhë pozitive, ndërsa klasa MTPL vazhdoi të raportojë 6-7% rënie, kryesisht si rezultat i çmimeve shumë të ndjeshme të tregut. Megjithatë, vlen të përmendet se ndërsa siguresit motorik slovenë arritën të përmirësojnë treguesit dhe pretendimet e tyre, vëllimi i dëmeve të paguara për sigurimin motorik pati rënie me 5.4% në 3 mujorin e tretë vitit të 2011.

Kosovë: Tregu në 3 mujorin e tretë të vitit 2011 mbyllet me një rritje prej 7%

Nëntëmujori i parë i vitit 2011 paraqet për kompanitë e sigurimeve, që veprojnë në Kosovë, një vëllim të primeve të shkruara bruto prej 58.7 milion euro, krahasuar me 2010, një evolucion në rritje prej 7%. Kjo vlerë është gjeneruar prej mbi 465.000 polica sigurimi të shitura në periudhën e analizuar. Karakteristika e tregut të ri është mbështetja fuqimisht nga linjat e praktikuara të sigurimit, 60% e portofolit të tregut lokal i atribuohet sigurimit MTPL. Dëmet e paguara të

siguresit arritën në 19.7 milion euro.

Në Kosovë operojnë dhjetë kompani në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës, e cila ka qenë e pavarur që nga viti 2000, ku disa prej tyre janë anëtare të njohura të subjekteve të sigurimit evropian si Vienna Insurance Group, Unica, Grawe, Kroaci Osiguranje ose Sava Re. Në të njëjtën kohë, sigurimi privat i Jetës ka qenë i disponueshëm që nga viti 2008 me vetëm një sigures të Jetës që vepron në tregun e sigurimeve të Kosovës.

Nëntëmujori i parë i vitit 2011 paraqet për kompanitë e sigurimeve, që veprojnë në Kosovë, një rritje të primeve të shkruara bruto prej 7% krahasuar me 2010.

Për këtë numër punuan:

*E. Shehi, R. Guri, D. Kalaja, A. Dervishi, T. Cani, F. Musta,
M. Vaska, Dh. Hazbiu, R. Eltari, E. Kokona*

